



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri  
Mbledhja nr. 36  
Prishtinë, më 25 Nëntor 2009  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301  
Mbledhja filloi në orën 12:00

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**

**Morën pjesë anëtarët e komisionit:** Rrustem Mustafa, Suzana Novoberdaliu, Melihate Termkollu, Eqrem Kryeziu dhe Zylfi Merxha.

**Munguan:** Zafir Berisha, Shkumbin Demaliaj, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanovič.

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Nur Çeku, Nuredin Ibishi, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rrustem Mustafa, kryetari i komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **06.11.2009**
3. Shqyrtimi i zbatimit të ligjit për Policinë e Kosovës
4. Të ndryshme

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të datës 06.11.2009**

*Procesverbali i datës 06.11.2009 u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i zbatimit të ligjit për Policinë e Kosovës**

**Kryetari i Komisionit – tha,** ju e dini se Ligji për Policinë nuk është duke u zbatuar plotësisht. Duke pasur parasysh edhe raportin e progresit i Komisionit Evropian ku është kërkuar që Kuvendi i Kosovës të rris mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, unë propozoj që grupi i punës të formohet nga tre anëtarë dhe të përpilojë një raport për mos zbatimin e këtij ligji. Unë propozoj Shkrumbin Demaliaj, Zafir Berisha, dhe Suzana Novoberdaliu. A pajtoheni për këtë përbërje të grupit të punës?

*Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin për formimin e grupit të punës.*

### **5. Të ndryshme**

**Kryetari i Komisionit – tha,** ju njoftoj se ka ardhur vendimi për Projektligjin për Buxhetin e vitit 2010 i cili u miratua në parim. Ne si komision funksional mund ta shqyrtojmë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 nga aspekti i fushëveprimit tonë. Jeni të ftuar të jepni komentet e juaja për vijat buxhetore tona.

Ka ardhur një ftesë për një Konferencë rajonale dy ditore e cila do të mbahet në Shqipëri për sektorin e sigurisë. Është i ftuar një delegacion prej pesë anëtarësh prej të cilëve dy do të shkojnë nga kryesia e Kuvendit dhe tre nga komisioni. Unë kam menduar që kësaj radhe të shkoj unë, Lulzim Zeneli dhe Suzana Novoberdaliu.

Mbledhjen e kaluar ju kemi caktuar referuese për Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Melihate Termkolli –** Unë nuk jam kundër të punoj për këtë projektligj, duke pasur parasysh se kam qenë e kyçur mjaft në përgatitjen e këtij ligji. Mirëpo, unë jam kryesuese në grupin punues për ligjin për shërbimin civil, dhe do të jem shumë e angazhuar.

**Suzana Novoberdaliu** – Unë mendoj që të caktohen dy referues që ta kenë më të lehtë punën për shqyrtimin e projektligjit.

**Kryetari i Komisionit – tha,** a pajtoheni me propozimin që deputetja Suzana të caktohet referuese për këtë projektligj?

*Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin.*

**Kryetari i Komisionit – tha,** duhet të mendojmë shumë seriozisht çështjen e rritjes së pagave të policëve. Unë nuk jam për ndryshimin e buxhetit, por duhet të gjenden mënyra për zgjidhjen e kësaj çështje.

**Melihate Termkoll** – Unë mendoj që ne si komision, është mirë të bëjmë një propozim amendament, ti dërgojmë komisionit për buxhet dhe financa, dhe gjatë shqyrtimit në këtë komision të gjendet mënyra. Ka shume vija buxhetore dhe secila e ka rëndësinë e vet, por jo aq sa ka rëndësi në këtë rast rritja e pagave të policëve apo rritja e pagave në shëndetësi.

*Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.*

Pasi që nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatiti:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit  
Rrustem Mustafa